



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

**KD.nr.6/2017**

**KOMISIONI DISIPLINOR**, në përbërje nga gjyqtarët, Skender Çoçaj, kryetar, Manushe Karaqi dhe Gjimshit Galushi, anëtar ë të Komisionit, në procedurën disiplinore ndaj Xxxx xxxxt, gjyqtar në Gjykatën e xxxx xxx xxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2016-071, në procedurën te Komisionit Disiplinor KGJK/KD/12/2016, për sjellje të pahijshme sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në seancën e mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, znj. Xxxx Xxxxxx, dhe Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxxx, më datën 18.04.2017, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, merr këtë:

**V E N D I M**

Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën e xxxxxx xxxx , është përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2016-071 i cili në procedurën te Komisioni Disiplinor ka marr numrin KGJK/KD/12/2016, sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 5 paragrafi 5.1 nën pikën 5.1.1 të Rregullores 04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve te pahijshme.

Gjyqtarit Xxxx xxxxx, i shqiptohet masa disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 30% për tre (3) muaj nga paga mujore, duke filluar prej fillimit të muajit pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

**A r s y e t i m**

Zyra e Prokurorit Disiplinor ja ka paraqitur Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Raportin përfundimtar ZPD-2016-071 se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar Xxxx xxxxxn, gjyqtar në Gjykatën xxxx në Xxxxxx për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore, 1.3-të dështuarit e kryerjes së funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe 1.4-shkelje e kodit të zbatueshëm të etikes të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ku ishin gjetur 14 lëndë për të cilat ishte vonuar përpilimi i aktgjykimeve .

Zyra e Prokurorit Disiplinor hetimin disiplinor e kishte filluar në bazë të parashtrës së ushtrueses së detyrës së kryetares të Gjykatës së xxxxx znj.Xxxxxx xxx. Më këtë njoftim ZPD është njoftuar se është një numër i konsiderueshëm i lëndëve për të cilat ka pasur vonës në përpilimin e aktgjykimeve. Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor ZPD deklaroi se hetimin disiplinor e kishte filluar dhe gjatë shqyrtimit paraprak kishte gjetur se prej 21 lëndëve janë vetëm 14 lëndë për të cilat ishte vonuar përpilimi i aktgjykimeve. Lidhur me këto të gjetura ZPD ka hartuar raportin të cilin ja ka dërguar Komisionit dhe i ka propozuar iniciimin e procedurës disiplinore për arsye se konsideron se janë bërë shkelje të të drejtave të njeriut dhe gjithashtu ka konsideruar se gjyqtari Xxxx xxxxx i ka neglizhuar këto lëndë.

Gjyqtari Xxxx xxxxx në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 18.04.2017, ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës të cilën e ka dhanë për ZPD-në, ku e ka pranuar shkelejn duke theksuar se arsye e vetme se pse ka ndodhur vonesa me këto lëndë, është se gjatë fund vitit të 2013 ka pasur rast vdekje në familje kur i ka vdekur vëllai prej infarktut dhe i kishte lënë dy vajza të vogla, të cilët kanë jetuar në xxx xxxxx, ka qenë në një gjendje të rëndë emocionale, dhe ishte i obliguar të kujdeset për dy vajzat e vëllait. Gjyqtari Xxxxxx ka deklaruar se personalisht nuk kishte veturë dhe i është dashur që për çdo ditë të shkojë në Fushë xxxxxx dhe mandej të shkojë në fshatin Zhabar të xxxxxx ku edhe ka jetuar. Ka theksuar se ka qenë shumë i keq dhe bile kishte menduar edhe që ta lejonte punën në mënyrë që të ketë kohë dhe të kujdesem për ato dy vajza. Nuk kam marrë pushim dhe e keqja me e madhe ka qenë se unë nuk kam kërkuar ndihmë nga të tjerët, dhe si pasojë e gjendjes time të rëndë me kanë mbetur lëndët pa u përfunduar, këto lëndë që i kam pas të votuara jam përpjekur që ti përfundoj dhe ta realizoj normën dhe jam shumë i lumtur që këto dy vajzat (mbesat) kanë filluar me përballuar dhimbjen ka deklaruar gjyqtari Xxxxxx. Me ndihmën psikologjike dhe me ndihmën e miqve kishte arritur të rikthehet prapë punës normale dhe se më nuk ka ndodhur asnjë problem me punën e tij

Ka deklaruar se e kishte njoftuar ushtruesen e detyrës së kryetarë së Gjykatës, por nuk kishte kërkuar ndihmë, edhe pse realisht ka pas nevojë për pushim. E kishte njoftuar kryetaren që i kanë mbetur lëndët, e kishte njoftuar se si është gjendja familjare dhe personale, për çka nuk kam mundur që ti përfundoj lëndët, dhe se kryetares asgjë më shumë nuk i kishte thanë. E kam kaluar këtë fazë dhe tani janë të kryera të gjitha me kohë. Gabimi im ka qenë se pse nuk kam kërkuar pushim mjekësor dhe ndihmë prej të tjerëve.

E gjitha çka është, është kjo, është rasti i dytë në karrierën time që më ka ndodhur të hetohem, por unë kurrfarë qëllimi nuk kam pasur lidhur me këto lëndë, vetëm se kam qenë emocionalisht i trazuar me fatkeqësinë familjare të ndodhur. Kryetarja vetëm ka kryer punën e vetë dhe e ka njoftuar ZPD-ën për këtë hetim disiplinor.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e ZPD-së deklaroj se zvarritja e lëndëve është shumë shqetësuese, e sidomos përpilimi i aktgjykimeve, është jashtë çdo norme. Pavarësisht kësaj bashkëpunimi me gjyqtarin Xxxxxx gjatë zhvillimit të hetimeve ka qenë shumë korrekt me çka është bërë që të dallohet nga të gjithë gjyqtaret tjerë. Për shkak të bashkëpunimit të mirë për të gjitha provat që na janë nevojitur gjatë fazës së hetimeve, sjellja e mirë e gjyqtarit e ka bërë që të dallohet jo vetëm zyrën tonë por edhe që të dallohet vetë nga gjithë gjyqtaret tjerë. Ne si zyre i kemi zhvilluar edhe të gjitha hetimet për punën e gjyqtarit në vitin 2016, ku të gjitha janë të përfshira në raportin përfundimtar ku për 7 muaj gjyqtari Xxxxxx i kishte kryer 156 lëndë. Për të gjitha këto, kërkoj nga Komisioni që të merren si rrethana lehtësuese.

Gjyqtari Xxxxxx në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron prapa deklaratës së dhënë të Zyra e Prokurorit Disiplinor se e vetmja arsye se pse ka ardhur deri të vonesa ka qenë fatkeqësia që i kishte ndodhur në familje dhe se nuk ka pasur asnjë qellim tjetër. Tani është në gjendje të mirë emocionale dhe se të gjitha lëndët i kryhen brenda afatit.

Pasi Gjyqtari Xxxxxx i ka pranuar të gjitha shkeljet që janë paraqitur në raportin përfundimtar të ZPD-së, Komisioni nuk i ka administruar provat rreth kësaj çështje.

Nga të gjitha rrethanat e lartpërmendura komisioni gjeti se gjyqtari Xxxx xxxxx është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe shkelje të Kodit të Etikës për Sjellje Profesionale për Gjyqtar.

Për këtë sjellje të pahijshme të vërtetuar të gjyqtarit Xxxx xxxxx, Komisioni i shqiptoi masën disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 30% për tre (3) muaj nga paga mujore, duke filluar prej fillimit të muajit pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm e kjo në pajtim me nenin 37 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenin 5 paragrafi 5.1 nën pikën 5.1.1 të Rregullores 04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të pahijshme.

Si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të masës disiplinore Komisioni mori gjendjen emocionale nën të cilat ishte ndodhur gjyqtari Xxxxxx, për shkak të fatkeqësisë familjare gjatë asaj periudhe, gjë që kishte ndikuar të gjyqtari dhe si pasojë e kësaj gjendje kishte ardhur deri të vonesa e përpilimit të aktgjykimeve. Mirëpo edhe përkundër gjithë fatkeqësisë, gjyqtari Xxxxxx ka vazhduar të kryej lëndë dhe tani i është kthyer normalitetit dhe tani është mjaft i suksesshëm në kryerjen e detyrave të tija.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR**  
**KD.nr.6/2017, date 18.04.2017**

Kryetar i Komisionit Disiplinor  
Gjyqtari, Skender Çoçaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur  
ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor  
të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh  
nga dita e pranimi të Vendimit.

Vendimi u dërgohet;

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxxx Xxxxx, kryetar i Gjykatës së xxxx në xxxxxx;
- Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën e xxxxx në xxxxxx;
- Administratës se Personelit në Sekretariatit e SKGJK-së;